

Shënim elektronik

Nr. i taksës 789732436955 1029 0069

Shuma 10 E

Shënim elektronik

Nr. i taksës 7897658224955 1029 0002

Shuma 5 E

### APOSTILLE – SHENIM

#### KONVENTA E HAGËS 5 TETOR 1961

1. Vendi: GREQI  
Akt publik
2. Është nënshkruar nga Gjeorgjia Andreou
3. E cila ka funksionuar me cilësinë e Sekretares së Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë
4. Ka vulën e Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë

Vërtetimi jepet

5. (Vendi) : Janinë
6. (Data) 2 Maj 2025
7. Nga Konstandino Panou, Kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë
8. ME NUMËR: **40/2-05-2025**
9. Vula
10. Firma

Konstandinos Panou

Kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë

**Praktikë dhe vendim i Gjykatës Penale të Shkallës së Parë me tre anëtarë**

Gjyqtarë	E pandehur	Vepra
Adhriani Lambropulu	Maneku Irena, dtl. 15.02.1970,	Shkelje e nenit
Kryesuese	Lindur në Fier, me nr. pasaporte	54§7 të ligjit
Jeorjos Petinarelis	1068376/98, me të dhëna të tjera	2910/2001
Hrisula Dhanxera	dhe banim të panjohur	
Pavlos Qirkos	Në mungesë	
Sekretar		

**PËRMBLEDHJE E PRAKITËS DHE VENDIM**

Në seancën e sotme të gjykatës, që u zhvillua publikisht në sallë, kryesuesja thirri emrin e të pandehurës, e cila nuk u paraqit, megjithëse u thirr sipas ligjit.

Siç rezulton nga dëftesa e komunikimit me datë 09.02.2005 e policit të Seksionit të Policisë së Kakavijës Janinë, Liapata Dhimitriu, letërthirrja me nr. 408/2004 e Prokurorit të Gjykatës Penale të Shkallës së Parë Janinë, me të cilën ftohet e pandehura të paraqitet në këtë gjykatë seancën e sotme, i`u njoftua ligjërisht dhe në afat Kryetarit të Bashkisë të Delvinaqit të Janinës sepse është i panjohur vendbanimi i të pandehurës. Letërthirrja u afishua nga nëpunësi i kësaj bashkie Kosta Toni, në vendin më publik të selisë së bashkisë. Etj.

Gjithashtu bashkë me letërthirrjen u dorëzua edhe lista e dëshmitarëve që duhet të pyeten. Si rrjedhojë e pandehura është thirrur sipas ligjit dhe në afat (nenet 156. 166 paragrafi 1 pika b e K.Pr.Penale) dhe meqenëse nuk u paraqit duhet të gjykohet si të ishte e pranishme (neni 340 paragrafi 3 K.Pr.Penale).

Prokurori, pasi mori fjalën, relatoi në mënyrë të përmbledhur dhe dhe me saktësi kërkesën për gjykim dhe tha se për mbështetjen e saj thirri një dëshmitar të akuzës dhe propozoi leximin e dokumentave.

Në vijim u thirr emri i dëshmitarit të akuzës, që nuk ishte prezent.

Më pas kryesuesja lexoi sa vijojnë: a) Proces verbal i sekuestrit datë 12.03.2004 dhe b) Ekspertimin laboratorik me nr. prot. 3022/17/6338-a/7-10-2003.

Prokurori, pasi mori fjalën nga kryesuesja, shtjelloi akuzën dhe propozoi fajësinë e të pandehurës.

Pas kësaj gjykata, në këshillim të fshehtë me prezencën edhe të sekretarit, mori vendimin e mëposhtëm, të cilin e shpalli nëpërmjet kryesueses në seancë publike

### Vlerësoi sipas ligjit

Meqenëse nga gjithë procedura, dokumentat që u lexuan dhe diskutimi i çështjes u provua se (shkrim dore) e pandehura ne datën 24.12.2002 u kap, gjatë kontrollit te pasaportes, ne posedim te pasaportes shqiptare me numrin 1068376/98 qe ishte e falsifikuar dhe konkretisht ishte e ndryshuar me nderhyrje VISA ne faqen 17 përsa i përket afatit të vlefshmërisë, me dijeninë e mbajtëses. Si rrjedhojë duhet që e pandehura të shpallet fajtore për këtë vepër

### Për këto arsyë

E gjykon të pandehurën në mungesë

E deklaron atë fajtore sepse: në datën 24.12.2002, në orën 15:30 në Kakavijë të Janinës, në kontroll pasaporte u kap të mbajë dokumenta udhëtimi të falsifikuara dhe konkretisht në vendin dhe kohën e mësipërme posedonte pasaportën e Shqipërisë me nr. 1068376/98, e cila ishte ndryshuar kështu: Tjetërsim VISA në faqen 17 të pasaportës përsa i përket afatit të vlefshmërisë dhe rrjedhimisht pasaporta e mësipërme provohet se është e falsifikuar.

U gjykua, u vendos dhe u shpall në sallën e gjykatës në Janinë më 7 Korrik 2005

Kryesuesja  
firma

Sekretari  
firma

Pas shpalljes së vendimit të mësipërm dëgjoi:

Prokurorin i cili propozoi që ndaj të pandehurës të deklaruar fajtore të vendosej dënim me burgim tre muaj dhe gjobë 1.500 Euro, si dhe t'i ngarkohen shpenzimet e gjyqit.

Më pas gjykata, në këshillim të fshehtë me prezencën edhe të sekretarit vendosi dhe shpalli menjëherë nëpërmjet kryesueses vendimin e mëposhtëm:

### Vlerësoi sipas ligjit

Meqenëse vepra për të cilën u shpall fajtore e pandehura dënohet nga nenet 4, 12, 16, 26 paragrafi 1a, 27 paragrafi 1, 51, 53. 79 94 paragrafi 1 Kodit Penal dhe neni 54§7 i ligjit 2910/2001.

Meqenëse gjykata, e cila mban parasysh rëndësinë e veprës penale që u krye nga e pandehura dhe personalitetin e saj dhe mori parasysh në vlerësimin e peshës së veprës pasojat që shkaktoi dhe rrezikun që erdhi prej saj, natyrën, llojin dhe objektin e krimtit, si dhe gjithë rrethanat e kohës, vendit, mjeteve dhe mënyrës, që shoqërojnë përgatitjen

dhe kryerjen e saj, si dhe shkallën e dashjes së të pandehurës, në vlerësim të personalitetit të të pandehurës nëpërmjet shkallës së treguar të predispositës për kryer veprën dhe identifikimit të shkaqeve që e shtynë të kryente veprën, arsyes që pati, qëllimit që synonte, karakterit të saj dhe shkallës së zhvillimit të tij, rrethanave personale dhe shoqërore dhe jetës së mëparshme të saj dhe sjelljes gjatë kryerjes së veprës, vlerëson se ndaj saj duhet të vendoset dënim i përmendur në dispozitiv.

Gjithashtu duhet t`i ngarkohen të pandehurës shpenzimet gjyqësore prej 73 Euro.

Për këto arsyе

E dënon të pandehurën të shpallur fajtore me burgim tre muaj, gjobë 1500 Euro, si dhe me shpenzimet gjyqësore prej 73 Euro.

U gjykua, u vendos dhe u shpall në sallën e gjykatës në Janinë më 7 Korrik 2005

Kryesuesja  
firma

Sekretari  
firma

Pas shpalljes së këtij vendimi, Kryesuesja i dha fjalën prokurorit që të propozojë mbi konvertimin ose jo të dënit të mësipërm kufizues të lirisë që u vendos ndaj të pandehurës.

Prokurori, pasi mori fjalën, propozoi të konvertohet dëni i mësipërm që u vendos ndaj të pandehurës në dënim monetar prej 4,4 Euro në ditë.

Pas kësaj gjykata, në këshillim të fshehtë me prezencën edhe të sekretarit, hartozi dhe kryesuesja shpalli menjëherë, në seancë publike, vendimin e gjykatës që është si më poshtë:

Pasi vlerësoi sipas ligjit

Sipas nenit 82, par. I të K.Penal dëni i kufizues i lirisë që nuk kalon një vit konvertohet në dënim monetar ose gjobë, përsa kohë nuk janë rrethanat e zbatimit të nenit 99, par. I të K.Penal. Në rastin konkret dëni i kufizues i lirisë që i u caktua të pandehurës nuk e kalon vitin, si rrjedhojë ai duhet të konvertohet në dënim monetar, duke qenë se nga karakteristikat e veprës dhe fakti se e pandehura është shtetase e huaj, gjykata çmon se ekzekutimi i dënit të është e nevojshme për ta shmangur nga kryerja e veprave të reja penale dhe kështu nuk mund të urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimis. Vlera e konvertimit duhet të përcaktohet, duke mbajtur parasysh gjendjen ekonomike të të pandehurës, në 4,4 Euro dita.

Për këto arsyе

Konverton dënimin e mësipërm me burgim që i`u vendos të pandehurës në dënim monetar dhe cakton shumën e konvertimit në 4,4 Euro për çdo ditë burgim.

U gjykua, u vendos dhe u shpall në sallën e gjykatës në Janinë më 7 Korrik 2005

Kryesuesja  
firma

Sekretari  
firma

Pas shpalljes së këtij vendimi kryesuesja i dha fjalën prokurorit që të propozojë mbi fatin e sendeve të sekuestruara.

Prokurori, pasi mori fjalën, propozoi të miratohet sekuestrimi i pasaportës, që u krye me procesverbalin e sekuestrimit të datës 10.02.2004 të nëpunësve hetimorë: 1) “grada” Karajanidhi Jeorjiu dhe 2) “grada” Griva Jeorjiu dhe të urdhërohet konfiskimi dhe asgjësimi i saj.

Pas kësaj gjykata, në këshillim të fshehtë me prezencën edhe të sekretarit, hartozi dhe kryesuesja shpalli menjëherë, në seancë publike, vendimin e gjykatës që është si më poshtë:

Pasi vlerësoi sipas ligjit

Sipas dispozitës së nenit 373 K.Pr.Penale me vendimin përfundimtar të gjykatës, urdhërohet konfiskimi i objekteve që duhet të konfiskohen. Më tej, sipas dispozitave të neneve 76, par. I dhe 3 të K.Penal, sendet që u krijuan nëpërmjet kimeve me dashje, si dhe çmimi i tyre dhe sa u përfituan nëpërmjet tyre, si dhe sendet që shërbyen ose ishin të destinuara për kryerjen e veprave penale, mund, nëse i përkasin autorit apo atyre që marrin pjesë në krim, të konfiskohen. Në çdo rast konfiskimi gjykata shprehet nëse sendet që u konfiskuan duhet të asgjësohen.

Në rastin konkret, me procesverbalin e sekuestrimit të datës 10.02.2004 të nëpunësve hetimorë: 1) “grada” Karajanidhi Jeorjiu dhe 2) “grada” Griva Jeorjiu, u sekuestrua: pasaporta shqiptare me nr. 1068376/98 që u gjet në posedim të të pandehurës, e cila duhet të konfiskohet dhe të asgjësohet.

Për këto arsyë

Miraton procesverbalin e sekuestrimit të datës 10.02.2004 të nëpunësve hetimorë: 1) “grada” Karajanidhi Jeorjiu dhe 2) “grada” Griva Jeorjiu.

Urdhëron konfiskimin dhe asgjësimin e sendeve që përmenden në këtë procesverbal.

U gjykua, u vendos dhe u shpall në sallën e gjykatës në Janinë më 7 Korrik 2005

Kryesuesja  
firma

Sekretari  
firma